



REPUBLIKA E SHQIPERISE

GJYKATA E ADMINISTRATIVE E SHKALLES SE PARE TIRANE

Numri i Ceshtjes : 31158-01547-80-2020 Data e Regjistrimit : 18/03/2020
Numri i Vendimit: 80-2020-3156 Data e Vendimit : 01/12/2020

VENDIM

NE EMER TE REPUBLIKES

GJYKATA E ADMINISTRATIVE E SHKALLES SE PARE TIRANE E PERBERE NGA:

GJYQTAR: {...}

SEKRETARE: {...}

Sot me date 01/12/2020mori ne shqyrtim ne seance gjyqesore geshtjen civile qe i perket :

Padites {...} , i biri i dhe i , i datelindjes 18/06/1980 I Paditur Drejtoria e pergjithshme e pronesise Industriale

Objekti:Shpalljen e pavlefshmerise relative te akteve administrative, vendimit Nr. 33/ prot., date 24. 05. 2019, te Dhomes per Shqyrtimin e Kundershtimeve, dhe vendimit nr. 33/16 prot., te dates 17.12. 2019, te Bordit te Apelit te Drejtorise se Pergjithshme te Pronesise Industriale, per shkak se jane marre ne zbatim te gabuar te ligjit dhe analizim te gabaar te rrethanave te faktit. 2. Ndryshimin e ketyre vendimeve duke vendosur pranimin e kundershtimit te paditesit ndaj aplikimit per regjistrimin e markes tregtare kombetare me numer kerkese AL/T/2017/33, date 13. 01.2017, si dhe refuzimin e regjistrimit te kesaj marke per te gjitha mallrat qe eshte kerkuar mbrojtja.

Baza Ligjore:Shpalljen e pavlefshmerise relative te akteve administrative, vendimit Nr. 33/ prot., date 24. 05. 2019, te Dhomes per Shqyrtimin e Kundershtimeve, dhe vendimit nr. 33/16 prot., te dates 17.12. 2019, te Bordit te Apelit te Drejtorise se Pergjithshme te Pronesise Industriale, per shkak se jane marre ne zbatim te gabuar te ligjit dhe analizim te gabaar te rrethanave te faktit. 2. Ndryshimin e ketyre vendimeve duke vendosur pranimin e kundershtimit te paditesit ndaj aplikimit per regjistrimin e markes tregtare kombetare me numer kerkese AL/T/2017/33, date 13. 01.2017, si dhe refuzimin e regjistrimit te kesaj marke per te gjitha mallrat qe eshte kerkuar mbrojtja.

Ne perfundim te shqyrtimit gjyqesor te kesaj geshtje,

Perfaqesuesi i pales paditese kerkoi:

•€€€€€€€€ Pranimin e kerkesepadise.

Perfaqesuesi i pales se paditur juristi Marsid Sedja kerkoi:

•€€€€€€€€ Rrezimin e kerkese-padise si te pabazuar ne ligj dhe ne prova.

Perfaqesuesi i personit te trete av.Elton Peppo kerkoi:

•€€€€€€€€ Rrezimin e kerkese-padise si te pabazuar ne ligj dhe ne prova.

Dhe ne mungese te Avokatures se Shtetit e cila ka deleguar te drejten e perfaqesimit dhe mbrojtjes, Gjykata pasi shqyrtoi geshtjen ne teresi dhe analizoi provat e paraqitura nga palet ndergjyqese dhe te administruara gjate gjykimit,

VEREN :

Veren:

Se paditesi Shoqeria {...}shpk i eshte drejtuar kesaj Gjykate me padine me objektin dhe bazen ligjore te cituar ne pjesen hyrese te vendimit , si Gjykata kompetente nga pikepamja lendore dhe tokesore per gjykimin e geshtjes.

Nga shqyrtimi ne teresi i akteve shkresore te praqitura nga palet ndergjyqese rezultoi e provuar se :

Paditesi, eshte nje shoqeri tregtare e mirenjohur ne Republiken e Shqiperise dhe ne rajon ne fushen e prodhimit, tregtimit, shperndarjes, shitjes dhe ofrimit per shitje te pijeve alkoolike,. Marka me numer regjistrimi kombetar 45, 10313, 8448, 10314, 10315, 10316, 10317, 10318, 10319, 11527, 11528, 1159, 11530, 8148, (fjale dhe figure), e regjistruar kryesisht per mallra te klases 33, te klasifikimit te Nicesku , me i famshmi eshte brendi «Gjergj Kastrioti {...}».

Personi i trete, Shoqeria "Kantina e Pijeve Gjergj Kastrioti {...}" sh.a eshte nje shoqeri tregtare e mirenjohur ne Republiken e Shqiperise dhe ne rajon ne fushen e prodhimit, tregtimit, shperndarjes, shitjes dhe ofrimit per shitje te pijeve alkoolike qe mbajne marka te ndryshme si: "Gjergj Kastrioti {...}", "BATO", "Doruntina", etj...Nje nder produktet me te mirenjohura dhe me te shitura te "Kantines se Pijeve" ne tregun vendas e te huaj jane pijet alkoolike te llojit brandy nen marken "Gjergj Kastrioti {...}" apo shkurtimisht "{...}".

Personi i trete ka paraqitur prane Drejtorise se Pergjithshme te Pronesise Industriale kerkesen me numer AL/T/2017/33, per regjistrimin e markes {...} (fjale e figure), kerkese e cila eshte depozituar ne DPPI duke marre si date depozitimi, ne kuptim te nenit 146, te Ligjit Nr.9947, "Per Pronesine Industriale" i ndryshuar, daten 13/01/2017.

Aplikanti ka kerkuar mbrojtjen e markes per mallra te klases 33 dhe klases 21 te Klasifikimit te Nices, ne menyre specifike per mallrat:

Klasa 33: "Pije alkoolike "

Klasa 21: "Shishe pijesh "

Kerkesa per regjistrimin e kesaj marke eshte publikuar per kundershtim ne Buletinin e Pronesise Industriale (Marka dhe Disenjo Industriale) me nr. 9/2017, date 02. 06. 2017.

Paditesi i ka paraqitur pales se paditur, kerkesen per kundershtimin e regjistrimit si marke tregtare te Aplikacionit me nr. AL/T/2017/33, kerkese e cila mban nr. 691 Prot., date 29.12.2017 me argumentin e ngjashmerise mes ketyre markave dhe mallrave.

Kerkesa e Paditesit eshte shqyrtuar nga i Padituri, ne instance te pare. Sipas vendimit me numer protokolli 33 pa fraksion, date 24.05.2019, Dhoma per Shqyrtimin e Kundershtimeve, ne baze te pikes 2 te nenit 143, nenit 152 dhe nenit 153, te Ligjit Nr. 9947, date 07.07.2008 "Per Pronesine Industriale" i ndryshuar, si dhe nenit 30, te VKM Nr. 315, date 31/05/2018 "Per Miratimin e Rregullores per Markat", me vendimin nr.33/ , date 24.05.2019 ka vendosur:

1. Rrezimin e kundershtimit te regjistrimit te markes {...}, me numer aplikimi AL/T/2017/33, me aplikant shoqerine "Kantina e pijeve Gjergj Kastrioti {...} SHA", dhe vijimin e procedurave te regjistrimit te saj.

2. Pala kundershtuese ka te drejte te apeloje kete vendim prane Bordit te Apelit brenda nje muaji nga data e marrjes se njoftimit.

Vendimi i Dhomes per Shqyrtimin e Kundershtimeve eshte apeluar nga paditesi ne Bordin e Apelit, ne mbeshtetje te pikes 2, te nenit 143, neneve 152 dhe 153 te ligjit nr. 9947, dt. 07.07.2008, "Per Pronesine Industriale", i ndryshuar, me vendimin nr. nr. 33/16, te dates 17. 12. 2019 ka vendosur: "Rrezimin e kerkeses per apelimin e aktit nr. 33/12 prot, date 24.5.2019, te Dhomes per Shqyrtimin e Kundershtimeve". Duke mos qene dakord me vendimarrjen e pales se paditur, pala paditese e ka bere geshtjen objekt konflikti gjyqesor duke kundershtuar vendimit nr.33/ Prot., date 24.05.2019, te Dhomes per Shqyrtimin e Kundershtimeve dhe vendimit nr.33/16 Prot., te dates 17.12.2019 te Bordit te Apelit te Drejtorise se Pergjithshme te Pronesise Industriale.

Paditesi ne parashtrimet e padise dhe konkluzionet perfundimtare me shkrim kerkoi pranimin e padise sipas percaktimit te kerkimeve te tij , ne mbeshtetje te ketyre argumenteve kryesore dhe perfundimtare:

Aplikacioni per regjistrimin e markes tregtare nr. AL/T/2017/33, eshte shume i ngjashem me familjen e markave tregtare te mirenjohura GJERGJ KASTRIOTI/{...}, te Paditesit, (ne vijim shkurt familja e markave {...}) dhe kerkon mbrojtje per mallra te njejta e te ngjashme.

Per shkak te kesaj ngjashmerie, mes ketyre markave dhe mallrave:

(i) Krijohet mundesia reale e shkaktimit te konfuzionit tek publiku, duke perfshire dhe mundesine e bashkelidhjes te markes se re te Aplikantit me familjen e markave Gjergj Kastrioti/{...} te Paditesit;

(ii) Marka e aplikuar merr perfitime te padrejta nga reputacioni i markave te Paditesit, bazuar ne perceptimin e konsumatorit qe marka e re e kundershtuara eshte pjese e familjes se markave Gjergj Kastrioti/{...} dhe prodhuesit (Paditesi e Aplikanti/Personi 3) jane te lidhur ekonomikisht mes tyre.

(iii) Prandaj, marka e re, nese regjistrohete, nepermjet perdorimit do tedemtoje karakterin dallues dhe reputacionin e familjes se markave te vjetra Gjergj Kastrioti/{...} te Paditesit.

Krahasimi i markave, si ne vijim : ngjashmeria midis mallrave dhe sherbimeve. Mallrat e kundershtuara ne klasen 33 jane te te njejtes natyre me mallrat e kundershtuesi : pije alkoolike dhe konsumohen ne rrethana te ngjashme. Ato jane identike. Persa i perket shisheve ne klasen 21 te mallrave te kundershtuara ato jane te destinuara dhe perdoren per pijet e gjithe llojeve, pra destinimi tyre eshte i njejte.(paragrafi katert dhe i peste, faqe 3 e vendimit nr. 33/pa fraksion protokolli).

Elementi dominant, elementi dallues/identifikues i paraqitjes grafike te markes se kontestuar, ne menyre te qarte eshte pjese e tekstit, fjala {...}. (paragrafi i pare, faqe 4 e vendimit nr. 33/pa fraksion protokolli). (krahasimi fontetik e kuptimor).

Marka e kontestuar ka si dekor te fjales {...} emblemen e Kastrioteve (paragrafi i dyte, faqe 4 e vendimit nr. 33/pa fraksion protokolli) (krahasimi vizual e kuptimor).

Marka e re e kontestuar ka perdorur per te kompozuar paraqitjen grafike te markes se saj pikerisht refrenin e elementeve te markave figurative te vjetra qe jane identifikuese te origjines se produktit, nga perdorimi i gjate dhe fama qe kane marre.Edhe ne aspektin pamor marka e kontestuar nuk i permbahet distances se nevojshme. (paragrafi i dyte dhe i trete, faqe 4 e vendimit nr. 33/pa fraksion protokolli)..(ngjashmeria vizuale/konceptuale).

Referuar pranise identike te ketyre elementeve ne marken e kontestuar, markat e vjetra kundershtuese dhe marka e re e kontestuar jo vetem qe nuk kane distance me njera tjetren, por jane te ngjashme deri ne perputhje. Kjo gje krijon premisat per ngaterrimin e markave te ballafaquara me njera-tjetren dhe mundesine e bashkalidhjes nga ana e konsumatorit te markes se kontestuar me markat, produktet tregtare dhe kompanine e Paditesit.(paragrafi i dyte, faqe 4 e vendimit nr. 33/pa fraksion protokolli)(rrisku per konfuzion dhe bashkalidhje mes markave dhe pronareve te tyre).

a. Marka me numer AL/T/2017/33 eshte aplikuar ne keqbesim. Aplikantit/Personi 3, nuk mundet te perdori emrin GJERGJ KASTRIOTI/{...} si emer tregtar. Prania e keqbesimit rrezon gdo mbrojtje te nje marke te mirenjohur dhe rrezon gdo kerkese per ta regjistruar ate. (paragrafi i gjashte dhe i shtate, faqe 4 e vendimit nr. 33/ pa fraksion protokolli).

b. Ne perfundim, duke qene se aplikimi per marken Rose AL/T/2017/33, cenon haptazi te drejtat e meparshme te Kundershtuesit, bazuar ne dispozitat perkatese ligjore, Paditesi ka kerkuar refuzimin e regjistrimit per te gjitha mallrat e klases 21, 33 sipas klasifikimit te Nices.

Rezulton se vetem me fjalen {...}, pa shenjen "Gjergj Kastrioti/{...}" dhe emblema, aplikimi nr. AL/T/2017/33, nuk mundet te qendroje praktikisht si marke, dhe, ligjerisht, nuk mundet te regjistrohete.

Ne kete kuptim, nuk eshte elementi literalo-figurativ "Rose", por jane shenjat "Gjergj Kastrioti", "{...}" i stilizuar dhe emblema, bashke me ngjyrat kuq e zi, qe ndihmojne publikun dhe kanalet tregtare per te identifikuar produktin e markes AL/T/2017/33, date 13 janar 2017.

Rezulton e provuar se thelbi i mosmarrveshjes dhe i kundershtimit nga "ADOL" sh.p.k., per regjistrimin e markes AL/T/2017/33, "{...}"

“Gjergj Kastrioti/{...}” dhe emblema, “qe nga 1933””, pra dhe i ketij gjykimi eshte fakti se shenjat e aplikimit te Personit te trete, date 13 janar 2017, imitojne shenjat “Gjergj Kastrioti/{...}” dhe emblema te paditesit dhe nderhyjne ne te drejtat e e mbrojtura prej markave te regjistruara prej tij, qe nga 11 qershori 1993, ora 12.40’.

Gjate hetimit gjyqesor u vertetua fakti po aq i rendesishem per perfundimet e ketij gjykimi, se asnje nga palet : Paditesi, {...} sh.p.k., dhe Personi trete, “Kantina e Pijeve Gjergj Kastrioti {...} sh.a.”, nuk disponon dhe nuk pretendon te drejta ekskluzive mbi elementin literalo-figurativ {...}. Keshtu qe, evidentojme, me theks te shtuar, se objekt i mosmarrveshjes mes paleve ne proceduren administrative dhe gjate ketij shqyrtimi gjyqesor, nuk ka patur dhe nuk ka si te kete lidhje me shenjen {...}.

Markat e familjes shqiptare te paditesit {...} sh.p.k., “Gjergj Kastrioti/{...}” dhe emblema, jane marka seri, dhe kane te perbashketa : emrin : Gjergj Kastrioti; pseudonimin {...}, me shkrim te stilizuar, emblemen e Gjergj Kastriotit; ngjyrat kuqezi, e arte dhe e bardhe; medaljet, dhe jane te regjistruara per mallra ne klasen 33.

Paditesi i provoi me dokumeta shkresore Gjykates se personi i trete, qe eshte aplikanti per regjistrimin e markes “ {...} “Gjergj Kastrioti/{...}” dhe emblema, “qe nga 1933””, eshte themeluar si shoqeri tregtare anonime vetem ne 2 gusht 1995 dhe eshte regjistruar si person juridik me emrin “Kantina e Pijeve Gjergj Kastrioti {...}” sh.a., vetem ne 16 gusht 1995.

Gjate hetimit gjyqesor DPPI, i padituri, nuk ka depozituar asnje prove te cilat i ka patur ne vleresim per vendimmarrjen e Dhomes se Kundershtimeve dhe Bordit te Apelit, qe eshte objekt i ketij gjykimi. Jo vetem kaq por DPPI, i padituri, ka refuzuar pa shkak ligjor te paraqesi ne gjykim dokumenta me rendesi per geshtjen kerkuar nga paditesi ne seancen e dates 13 tetor 2020.

Konkretisht, te dy vendimet jane marre :

T- Ne zbatim te gabuar te neneve 142/1.(a), 143/2. (b),(c),(g), 143/5. (b),(g), 152/1.(a) te ligjit specifik, LPI, (i ndryshuar);

II. Ne vleresim te gabuar te rrethanave te faktit si dhe kritereteve te percaktuara nga neni 143/2.(b),(c),(g), 143/5. (b),(g), 152/1.(a) te LPI,(i ndryshuar) si dhe nga praktika shqiptare dhe ajo europiane ;

III. Ne zbatim te gabuar te neneve 48, 82 dhe 139 te Kodit te Procedurave Administrative.

IV. Ne aplikim te nje gjykimi analitik hipotetiko-virtual, imagjinar, per krahasimin e ngjashmerise mes markave te ballafaquara dhe mallrave te cilat ato mbulojne.

V. Ne kundershtim dhe ne shkelje flagrante te parimeve dhe standarteve te pergjithshme te krahasimit te konsoliduara nga praktika e fushes se Pronesise Industriale, ne Shqiperi dhe ne Bashkimin European (EUIPO).

Aplikimi i markes se kundershtuar dhe ballafaqimi me familjen e markave {...} te Paditesit, eshte rasti klasik i keqbesimit ndaj markave seri. Konkretisht, koncepti i njejte {...} vs. {...} si dhe emri Gjergj Kastrioti/{...}, prezenca e shqiponjes dykrenare, heraldikes se Kastrioteve, dhe pseudonimi i Heroit, me shkrimin e stilizuar, te pranishme tek te dyja krahet, bashke me ngjyrat kuq e zi, tek markat ne ballafaqim, do ti gojne konsumatorit t’i perceptojne keto produkte si te ardhura nga e njejta familje; familja e markave Gjergj Kastrioti {...}, dmth do te mendoje qe produktet vijne nga e njejta sipermarrije apo me e pakta, nga sipermarrije te lidhura me njera-tjetren. Per sa me siper markes se kundershtuar nuk duhet ti jepet mbrojtje.

Pala e paditur permes perfaqesuesit te autorizuar nepermjet prapesimeve me shkrim, kerkoi rrezimin e kerkesepadise si te pambeshtetur ne ligj dhe ne prova, duke referuar ne keto argumente kryesore dhe perfundimtare:

Dhoma per Shqyrtimin e Kundershtimeve, ka perqendruar diskutimin ne tre ceshtje kryesore:

a) ngjashmerine mes markave;

b) ngjashmerine mes mallrave per te cilat mbrohen markat ne konflikt;

c) ekzistencen e mundesise qe te shkaktohet konfuzion tek konsumatori ose bashkelidhje mes markave per shkak te ngjashmerive te mesiperme.

Mbi bazen e analizes se mesiperme, Dhoma per Shqyrtimin e Kundershtimeve, ne baze te pikes 2 te nenit 143, nenit 152 dhe nenit 153, te Ligjit Nr. 9947, date 07.07.2008 “Per Pronesine Industriale” i ndryshuar, si dhe nenit 30, te VKM Nr. 315, date 31/05/2018 “Per Miratimin e Rregullores per Markat”, me vendimin nr.33/, date 24.05.2019 ka vendosur: Rrezimin e kundershtimit te regjistrimit te markes {...}, me numer aplikimi AL/T/2017/33, me aplikant shoqerine “Kantina e pijeve Gjergj Kastrioti {...} SHA”, dhe vijimin e procedurave te regjistrimit te saj.

Personi i trete permes perfaqesuesit te autorizuar nepermjet prapesimeve me shkrim dhe konkluzioneve perfundimtare me shkrim , kerkoi rrezimin e kerkesepadise si te pambeshtetur ne ligj dhe ne prova, duke referuar ne keto argumente kryesore dhe perfundimtare:

Rezultoni shume qarte se kerkese-padia duhet rrezuar per shkak se:

(i) Nuk kemi asnje zbatim te gabuar te ligjit material nga Bordi i Apelit;

(ii) Markat nuk jane te ngjashme ndermjet tyre ne teresine e elementeve perberes te tyre;

(iii) Objekti i procedurave administrative te kundershtimit eshte marka {...} dhe jo elementi perberes i saj “Gjergj Kastrioti {...}”;

(iv) Gjykata nuk mund te dale jashte objektit te gjykimit, i cili eshte gjithsesi i kufizuar ne procedurat e kundershtimit per regjistrim te markes {...} dhe jo ne kundershtimin e markave te regjistruara “Gjergj Kastrioti {...}”;

(v) Ne gdo rast, eshte provuar qartesisht perpara gjykates se Paditesi nuk gezon te drejta ekskluzive mbi marken “Gjergj Kastrioti {...}” per aq kohe sa “Kantina e Pijeve” ka ne pronesi 3 marka te regjistruara “Gjergj Kastrioti {...}”.

Elementi i kontenstuar nga Paditesi eshte elementi “Kantina e Pijeve Gjergj Kastrioti {...}”, i cili eshte njeri prej elementeve perberes te markes dhe qe perfaqeson njekohesisht marken + emrin e regjistruar te biznesit te personit te trete. Krahas detyrimit ligjor te percaktuar nga ligji per ushqimin dhe ligji per mbrojtjen e konsumatorit per te vendosur emrin e prodhuesit/tregtarit ne etiketen e produkteve te tij, konkludojme se ky element mundeson edhe me shume shmangien e konfuzionit ne rradhet e konsumatoreve duke dalluar qartesisht origjinen tregtare te mallrave.

Nepermjet kerkese-padise, Paditesi kerkon shfuqizimin e aktit administrativ qe ka vendosur vijimin e regjistrimit te markes {...} duke i cilesuar vendimet e Bordit te Apelit dhe Dhomes Per Shqyrtimin e Kundershtimeve si akte te paligjshme. Ligji nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative te Republikes se Shqiperise” percakton shprehimisht rastet per te cilat nje akt mund te konsiderohet si absolutisht i pavlefshem apo i paligjshem.

Per sa me siper, Paditesi nuk identifikon dhe nuk percakton asnje dispozite konkrete te ligjit mbi bazen e te ciles mund te konsiderohet se akti administrativ i kontestuar eshte i paligjshem. Ne gdo rast te mundshem, si dhe duke marre parasysh natyren e pretendimeve te Paditesit, theksojme se nuk ekziston asnje shkak ligjor per te konkluduar se akti administrativ eshte i paligjshem apo se eshte marre ne kundershtim me ligjin material.

Te gjitha argumentet e Paditesit per refuzimin e regjistrimit te markes {...} (AL-T-2017-33) dhe zbatimin e gabuar te ligjit material nga Bordi i Apelit i DPPI-se dhe Dhoma e Kundershtimeve, mbeshteten padrejtesisht dhe ne menyre teresisht te gabuar mbi markat tregtare “GJERGJ KASTRIOTI {...}”, te cilat nuk lidhen ne asnje rast me marken e kundershtuar: {...}.

Sig u tha me siper, perserisim ne menyre te permbledhur se objekti i kundershtimit dhe kerkese-padise nuk mund te jete marka “Gjergj Kastrioti {...}” e Personit te trete, por duhet t’i referohet markes {...}. Ne rast se Paditesi apo ndonje person i trete ka ndonje pretendim mbi vlefshmerine dhe regjistrimin e markave “Gjergj Kastrioti {...}” te Personit te trete, atehere ai duhet te inicoje procedura te veganta per shfuqizimin e ketyre markave.

Bazuar ne ligjin nr. 49/2012 “Per gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrveshjeve administrative”, Gjykata nuk mund kurresesi te gjykoje vlefshmerine e markave te tjera te regjistruara te Personit te trete (te ndryshme nga marka {...}-objekti i gjykimit/akti administrativ i kontestuar) dhe te dale jashte ketij objekti te gjykimit administrativ.

Pasi analizoi ne teresi geshtjen, aktet shkresore te paraqitura me cilesine e proves nga palet ndergjyqese dhe te administruara

gjate gjykimit, Gjykata, gmon se kerkesepadia duhet rrezuar , per arsye se:

Se pari: Gjykata fillimisht konstaton se geshtja ben pjese ne juridiksionin e saj gjyqesor ne baze te nenit 36 e vijues te Kodit te Procedures Civile dhe ne nenet 7, germa "a" dhe 11, pika 1 te ligjit 49/2012 "Per gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarreveshjeve administrative", ajo ka kompetencen lendore dhe tokesore per gjykimin e geshtjes.

Se dyti: Pala paditese legjitimohet ne ngritjen e kerkesepadise respektive, sipas nenit 15, shkronja "a" te ligjit 49/2012, duke qene se paditesi pretendon te jete cenuar ne te drejtat e tij te pronesise te nje marke te meparshme.

Se treti: Qeshtja eshte gjykuar ne themel te pretendimeve te saj, pasi nuk u gjend e shkelur asnje dispozite ligjore lidhur me mosrespektimin e kushteve formale te padise me pasoje mospranimin e saj ne gjykate. Paditesi ka ezauruar rrugen administrative te ankimit ne kuptim te nenit 16 te ligjit 49/2012 i ndryshuar sipas parashikimit te ligjit specifik nr. 9947, date 7.07. 2008 "Per pronesi Industriale", i ndryshuar (nenet 140/1.a ; 142/1.a ; 143/1,2.b,c,g, neni 143/5, 152, pika 1/a, 153/a, 193/b te LPI, (i ndryshuar). Gjithashtu nuk u gjend i shkelur afati ligjor per paraqitjen ne gjykate te padise sipas nenit 184/g, te ligjit 9947 /2008 te ndryshuar si dhe ligjit te pergjithshem mbi gjykimin administrativ neni 18, pika 1, germa 'a' e ligjit 49/2012.

Lidhur me zgjidhjen ne themel te geshtjes , ne analize te pretendimeve te pales paditese ne parashtrimet e padise, gjykata evidenton se lidhur me paligjshmerine e akteve administrative objekt gjykimi, pala paditese e ka orientuar shqyrtimin gjyqesor ne analizen e ekzistences ose jo te shkaqeve te pavlefshmerise relative ne lidhje me pa bazueshmerine ne ligj dhe prova te akteve administrative te kundershthuara , referuar nenit 109 pika "d" te Kodit te Procedurave Administrative , i cili percakton:"

Nje akt administrativ eshte i paligjshem nese:

- a) organi publik qe e ka nxjerre ka vepruar ne mungese te kompetences;
- b) eshte rezultat i shkeljes te dispozitave lidhur me proceduren administrative;
- c) eshte ne kundershtrim me dispozitat qe rregullojne formen apo elementet e detyrueshme te aktit administrativ; g) eshte nxjerre ne mungese te autorizimit nga nje ligj, sipas pikes 2, te nenit 4, te ketij Kodi;
- d) eshte ne kundershtrim me ligjin material;
- dh) eshte rezultat i diskrecionit te ushtruar ne menyre jo te ligjshme; apo
- e) nuk eshte ne perputhje me parimin e proporcionalitetit."

Gjykata i referohet analizes se verifikimit te ligjshmerise se aktit administrativ objekt gjykimi ne konsiderate te nenit 37 pika 1 te ligjit nr. 49/2012 sipas te cilit ligjshmeria e veprimit administrativ qe kundershtohet analizohet ne baze te provave te paraqitura nga palet dhe situates ligjore dhe faktike qe ekzistonte ne kohen e kryerjes se veprimit.

Gjate analizimit te kesaj geshtje gjykata i referohet ligjit specifik Ligjit nr. 9947, date 07.07.2008 "Per Pronesine Industriale" i ndryshuar e konkretisht :

Neni 142 :Refuzimi ose shfuqizimi per shkaqe absolute

1. Nje shenje nuk regjistrohesh si marke ose nese regjistrohesh, mund te shfuqizohesh kur: a) nuk ka karakter dallues; b) perbehet ekskluzivisht nga elemente ose tregues, qe sherbejne ne treg per te treguar llojin, cilesine, sasine, qellimin, vleren, origjinen gjeografike ose kohen e prodhimit te mallrave apo te kryerjes se sherbimeve, ose per te treguar karakteristika te tjera te mallrave apo te sherbimeve; c) perbehet ekskluzivisht nga elemente ose tregues, qe jane bere te zakonshem ne gjuhen e perditeshme apo qe jane kthyer ne praktika tregtare; g) perbehet nga forma ose vija, te imponuara nga vete natyra e mallrave apo e sherbimeve dhe/ose forma apo linja thelbesore, per te permbushur nje rezultat teknik; d) perbehet nga forma, qe u japin mallrave nje vlere thelbesore; dh) perbehet nga elemente, qe cenojne interesin publik ose qe bien ne kundershtrim me vlerat morale apo rendin publik; e) perbehet nga elemente, qe kane prirje te gorientojne publikun per natyren, cilesine, origjinen gjeografike ose tregtare te mallrave dhe/ose sherbimeve, qe ato kane per qellim te dallojne; e) perbehet nga tregues gjeografike, per vererat ose pijet alkoolike, qe nuk e kane origjinen gjeografike nga vendet, qe tregohen ne keta tregues, edhe nese tregohet origjina e vertete e produkteve, ose treguesit gjeografike jane perkthyer apo shoqeruar me shprehje te tilla, si "lloji" "tipi" "stili" "imitimi" ose shprehje te ngjashme; g) perbehet nga: i) emra shtetesh (te plote ose te shkurtuar); ii) emblema shtetore, medalje, urdhra nderi; iii) vula dhe shenja zyrtare te miratuara nga vendi; iv) emblemat e organizatave te njohura nderkombetare ose shkurtimet e tyre; v) simbolet fetare; vi) flamujt kombetare; gj) perbehet nga elemente, qe bien ne kundershtrim me nenin 6 ter te Konventes se Parisit, perveg kur autoritetet kompetente kane autorizuar perdorimin e tyre. h) nuk perben marke, sipas nenit 140 te ketij ligji; i) permban ose perbehet nga nje emertim origjine ose nje tregues gjeografik, me efekt ne territorin e Republikes se Shqiperise, nese kerkesa per regjistrimin e markes eshte dorezuar pas dates se dorezimit te kerkeses per regjistrimin e emertimit te origjines ose treguesit gjeografik dhe me qellim mbrojtjen e tyre, te parashikuar ne legjislacionin, ne baze te te cilit jane regjistruar ato dhe qe kane lidhje me te njejtin lloj produktesh. 65 2. Nje shenje nuk perjashtohet nga regjistrimi si marke, ne perputhje me shkronjat "a", "b" e "c", te pikes 1, te ketij neni, ne qofte se marka, objekt shqyrtimi, ka fituar karakter dallues ne procesin e perdorimit perpara dates se aplikimit. Nje marke tregtare nuk mund te zhvleresohet per te njejtat arsye, nese, para dates se kerkeses per shfuqizim, per shkak te perdorimit te saj, ajo ka fituar karakter dallues.

Neni 143 : Refuzimi ose shfuqizimi per shkaqe relative

1. Marka nuk mund te mbrohet nese perdorimi i saj bie ne kundershtrim me te drejtat e meparshme. 2. Marka nuk mund te regjistrohesh ose, nese eshte regjistruar, ajo duhet te deklarohet e pavlefshme kur: a) eshte e njejte me nje marke te meparshme dhe mallrat e sherbimet, per te cilat eshte aplikuar ose regjistruar ajo, jane identike me mallrat ose sherbimet, per te cilat eshte mbrojtur marka e meparshme; b) eshte e njejte ose e ngjashme me nje marke te meparshme, e cila mbrohet per mallra apo sherbime identike ose te ngjashme dhe kur, per shkak te njellojshmerise ose te ngjashmerise, ekziston mundesia e shkakimit te konfuzionit te publiku, ku perfshihet edhe mundesia e bashkelidhjes me marken e meparshme; c) eshte e njejte ose e ngjashme me nje marke te meparshme, edhe kur eshte per t'u regjistruar ose eshte regjistruar per mallra apo sherbime, qe nuk jane te ngjashme me ato, per te cilat eshte regjistruar marka e meparshme, kur marka e meparshme ka nje reputacion ne Republikën e Shqiperise dhe perdorimi ose regjistrimi i markes ne fjale, pa shkak te arsyeshem, fiton prioritet te padrejte ose demton natyren dalluese apo emrin e mire te markes se meparshme. g) nese kerkesa per regjistrimin e saj eshte bere ne keqbesim. 3. Marka nuk mund te regjistrohesh ose, nese eshte regjistruar, ajo deklarohet e pavlefshme, nese cenon te drejtat e meparshme, te fituara, si: a) te drejten e emrit tregtar, me kusht qe ky emer ose pjesa thelbesore e tij te jete e njejte apo e ngjashme me marken, qe kerkohet te regjistrohesh, dhe qe pronari i emrit tregtar te prodhoje apo te siguroje perkatesisht mallra ose sherbime, te njejtat ose te ngjashme me ato te markes, qe kerkohet te regjistrohesh; b) te drejten e nje individi, emri, mbiemri ose pamja e jashtme e te cilit eshte e njejte ose e ngjashme me marken, qe kerkohet te regjistrohesh; c) te drejtat e pronesise industriale, emrat e varieteteve te mbrojtura, bimore dhe/ose shtazore dhe te treguesve gjeografike. g) te drejtat e autorit te nje vepre ose te nje pjese te saj, me kusht qe ajo te jete e njejte ose e ngjashme me marken, qe kerkohet te mbrohet. 66 d) te drejtat e nje marke te paregjistruar ose nje shenje tjetere, te fituara nga perdorimi per nje kohe te gjate ne nje aktivitet tregtar dhe shtrirja e gjere territoriale. 4. Marka nuk mbrohet, nese eshte e njejte ose e ngjashme me nje marke te regjistruar, per mallra apo sherbime te njejtat ose te ngjashme dhe nese vlefshmeria e saj ka mbaruar per shkak te mbarimit te afatit te mbrojtjes, per nje periudhe gjashtemujore nga mbarimi i ketij afati. 5. Marke e meparshme, ne kuptim te pikes 2 te ketij neni, vleresohet: a) marka, me nje date aplikimi per regjistrim me te hershme sesa data e aplikimit per

regjistrim e nje marke tjeter tregtare, duke pasur parasysh, kur eshte rasti, pretendimin per prioritet per ate marke, sipas nenit 147 te ketij ligji; b) marka, qe eshte regjistruar me pare, nepermjet nje marreveshjeje nderkombetare, ne te cilen Republika e Shqiperise eshte pale; c) aplikimi per nje marke, sipas percaktimit te shkronjave "a" e "b" te kesaj pike, ne varesi te regjistrimit te tyre; g) marka, e cila, ne daten e aplikimit per regjistrim, ose ne daten e prioritetit, ne rastet kur pretendohet per prioritet, eshte e mirenjohur ne Republiken e Shqiperise, ne kuptim te nenit 6 bis te Konventes se Parisit, te publiku i sektorit perkates, si rezultat i perdorimit, perfaqesimit, publikimit ose reklamimit. 6. Kriteret ne lidhje me markat e mirenjohura percaktohen ne vendimin e Keshillit te Ministrave per markat.

Nga provat e shqyrtuara ne gjykim rezultoi e provuar se Personi i trete ka paraqitur prane Drejtorise se Pergjithshme te Pronesise Industriale kerkesen me numer AL/T/2017/33, per regjistrimin e markes {...} (fjale e figure), kerkesa e cila eshte depozituar ne DPPI duke marre si date depozitimi, ne kuptim te nenit 146, te Ligjit Nr.9947, "Per Pronesine Industriale" i ndryshuar, daten 13/01/2017. Aplikanti ka kerkuar mbrojtjen e markes per mallra te klases 33 dhe klases 21 te Klasifikimit te Nices, ne menyre specifike per mallrat: *Klasa 33: "Pije alkolike", Klasa 21: "Shishe pijesh"*. Kerkesa per regjistrimin e markes {...}, me numer AL/T/2017/33 eshte publikuar ne Buletinin e Pronesise Industriale ne date 02/06/2017, ne perputhje me parashikimet e nenit 151, te Ligjit Nr.9947, date 07.07.2008, "Per Pronesine Industriale" i ndryshuar. Kunder kesaj marke eshte depozituar, me date 10/08/2017, kerkesa per kundershkrimin e regjistrimit te saj nga paditesi shoqeria ADOL.

Referuar vendimarrjes se pales se paditur rezulton se Dhoma per Shqyrtimin e Kundershtimeve e ka perqendruar diskutimin ne tre geshtje kryesore:

a) ngjashmerine mes markave;

b) ngjashmerine mes mallrave per te cilat mbrohen markat ne konflikt;

c) ekzistencen e mundesise qe te shkaktohet konfuzion tek konsumatori ose bashkelidhje mes markave per shkak te ngjashmerive te mesiperme.

a) *Ngjashmeria mes markave.*

Gjate analizes se ngjashmerise mes markave, eshte marre ne konsiderate teresia e elementeve perberes te tyre dhe pershtypja e pergjithshme qe shkaktojne ato tek konsumatori, duke u fokusuar me teper ne elementet qe luajne rolin kryesor ne krijimin e karakterit dallues te markave.

Ne kete kontekst, nga eshte bere analiza e ngjashmerise mes tyre, per te vleresuar sakte rrezikun per konfuzion apo bashkelidhjen mes tyre nga konsumatori.

Ne vijim te analizes se mesiperme, Dhoma per Shqyrtimin e Kundershtimeve gjykoi se:

- Nga pikepamja *vizuale*, markat nuk jane te ngjashme per arsye se elementet perberes te tyre jane te ndryshme, pasi:

Markat kundershuese perbehen nga sfonde dhe emertime te ndryshme. Elementet figurative te markave ne proces kundershkrimi, jane vizualisht te ndryshme dhe nuk kane ngjashmeri ne menyren e stilizimit te tyre. Elementi dominues ne pamjen e markes se kundershtuar eshte elementi verbal {...}, poshte se ciles eshte shkruar me shkrim te vogel "Kantina e Pijeve Gjergj Kastrioti {...} Durres Albania", per te cilen aplikanti i markes se kundershtuar „Kantina e Pijeve”, nga baza e te dhenave qe DPPI disponon, rezultojne te jene regjistruara tre marka tregtare, me emertimin „Gjergj Kastrioti {...}”.

- Nga pikepamja *fonetike*, markat jane te ndryshme pasi:

Markat kundershuese, perkatesisht me numra regjistrimi kombetar 45, 10313, 8448, 10314, 10315, 10316, 10317, 10318, 10319, 11527, 11528, 1159, 11530, nuk kane asnje ngjashmeri me shenjen e kundershtuar, pasi dhe fonetikiqisht jane te ndryshme.

- Ne *aspektin konceptual*, jane analizuar sidomos elementet fjale dhe figure te markave sepse konsumatori, ne rastin kur marka eshte kombinim i elementeve figurative me elementet fjale, ne pjesen dominuese e identifikon marken me emertimin e saj. Ne kete koncept markat kundershuese me numra kombetar regjistrimi 45, 10313, 8448, 10314, 10315, 10316, 10317, 10318, 10319, 11527, 11528, 1159, 11530 krahasuar me marken ne proces kundershkrimi nuk mund te keqorientojne konsumatorin, pasi jane shume te ndryshme si ne aspektin vizual po ashtu dhe ne aspektin fonetik.

a) *Ngjashmerine mes mallrave per te cilat mbrohen markat ne konflikt.*

Mallrat per te cilat jane aplikuar/regjistruar markat ne konflikt jane te njejta per klasen 33 te klasifikimit te Nices, por po te kemi parasysh analizen e mesiperme te ngjashmerise, per konsumatorin e te njejtave produkte, nuk ekziston mundesia e konfuzionit apo bashkelidhjes se origjines tregtare te mallrave.

b) *Ekzistencen e mundesise qe te shkaktohet konfuzion tek konsumatori ose bashkelidhje mes markave per shkak te ngjashmerive te mesiperme.*

- *Mundesia e shkaktimit te konfuzionit.*

Duke u bazuar ne analizen e mesiperme te detajuar te ngjashmerise, Dhoma vleresoi se nuk ka ngjashmeri ndermjet markes se kundershtuar dhe markave te meparshme, e tille qe te sjelle rrjedhimisht mundesine e konfuzionit ose e bashkelidhjes se tyre nga konsumatori.

-*Pretendimi per keqbesim*

Kundershtuesi (paditesi) pretendon ne argumentet e parashtruara se marka e aplikuar me numer AL-T-2017/33 eshte aplikuar ne keqbesim.

Dhoma vlereson se ky pretendim nuk eshte provuar, duke qene se kundershguesi nuk ka paraqitur asnje prove mbeshtetese.

-*Pretendimi per marke te mirenjohur*

Duke qene se te dy palet pjesemarrese ne procedure kundershkrimi, pretendojne se markat e tyre respektive jane te mirenjohura ne tregun vendas, Dhoma vlereson se keto pretendime nuk jane provuar, duke qene se si kundershguesi ashtu edhe pala e kundershtuar nuk kane paraqitur asnje prove mbeshtetese.

Dhoma dhe Bordi kane konstatuar se Paditesi ka te regjistruar markat kundershuese "Gjergj Kastrioti {...}" dhe qe Personi i trete ka te regjistruar gjithashtu tre marka "Gjergj Kastrioti {...}".

Sig provohet nepermjet provave te paraqitura ne kete gjykim (certifikatat e regjistrimit te markave "Gjergj Kastrioti {...}" ne emer te "Kantina e Pijeve Gjergj Kastrioti {...}"), personi i trete ka aplikuar dhe regjistruar prane DPPI-se duke filluar nga viti 2003 markat e meposhtme:

- AL 9722 (Statusi: E regjistruar prej vitit 2003 dhe e pakundershtuar deri me sot)

- AL 10060 (Statusi: E regjistruar prej vitit 2003 dhe e pakundershtuar deri me sot)

- AL 16857 (Statusi: E regjistruar prej vitit 2016 dhe e pakundershtuar deri me sot).

Aplikanti ka deklaruar rregullisht perjashtimin nga mbrojtja te elementeve "0.75ml; Vere, 11%vol; Rose", ndersa marka mbrohet ne teresi te saj duke perfshire edhe elementet e tjere figurative dhe literal (elementi literal {...}, ngjyrat, stema e Aplikantit, menyra e stilizimit te figurave geometrike, sfondi).

Elementet qe nuk mund te mbrohen ne nje kerkesa per marke jane te percaktuara ne nenin 142 te Ligjit Nr. 9947 date 07.07.2008 "Per Pronesine Industriale", i ndryshuar. Deklarimi i perjashtimit te fjales {...} apo elementeve te tjere nuk nenkupton qe keto elemente do te fshihen nga pamja e markes, por qe pronari nuk mund te kete pronesi ekskluzive mbi to.

Ne kuptim te nenit 142 te Ligjit Nr. 9947, nje shenje nuk regjistrohet si marke kur perbehet ekskluzivisht nga elemente qe sherbejne ne treg per te treguar llojin, cilesine, sasine, qellimin, vleren, ose karakteristika te tjera te mallrave/sherbimeve. Deklarimi i perjashtimit nga mbrojtja nuk nenkupton qe keto elemente do te fshihen nga pamja e markes, por qe pronari nuk mund te kete pronesi ekskluzive mbi to. Gjithashtu, ne baze te nenit 142 (2), nje shenje nuk perjashtohet nga regjistrimi si marke ne qofte se marka, objekt shqyrtimi, ka fituar karakter dallues ne procesin e perdorimit perpata dates se aplikimit.

DPPI nepermjet vendimit te Dhomes se Shqyrtimit te Kundershtimeve dhe Bordit te Apelit konfirmoi se markat nuk jane te ngjashme ndermjet tyre ne perfundim te analizës vizuale, fonetike dhe konceptuale ndermjet shenjave.

Analiza e ngjashmerise midis shenjave eshte nje proces objektiv qe merr ne krahasim elementet perberes te markave ne teresine e tyre dhe pershtypjen e pergjithshme qe ato shkaktojne tek konsumatore, duke u fokusuar ne elementet dominante dhe dallues te tyre.

Keshtu, bazuar ne teresine e elementeve perberes te markave dhe ne pershtypjen e pergjithshme qe ato shkaktojne tek konsumatori, si dhe duke u fokusuar ne elementet dominante dhe dallues te markave, rezulton se markat objekt-gjykimi jane teresisht te ndryshme ndermjet tyre dhe nuk mund te flasim per konfuzion apo bashkelidhje.

Analiza krahasuese e ngjashmerise midis markave ne nivel konceptual, vizual dhe fonetik nuk mund te bazohet vetem mbi nje element te veguar te markes, por ne teresine e pamjes se pergjithshme te saj. Per kete arsye, keto marka nuk mund te ngaterrohen dhe as te krijojne konfuzion ne rradhet e konsumatoreve per shkak se ato jane shume te ndryshme ne teresine e tyre.

Emri "Kantina e Pijeve Gjergj Kastrioti {...}" i vendosur mbi marken e regjistruar te personit te trete eshte njekohesisht emri i regjistruar i shoqerise dhe emri tregtar i personit te trete. Si rrjedhoje, ky element jo vetem nuk ka se si krijon konfuzion ne rradhet e konsumatoreve, por ndihmon akoma me shume ne evidentimin dhe dallimin e origjines tregtare te mallrave te personit te trete ne raport me ato te Paditesit. Marka e aplikuar ka mjaftueshem elemente qe e ben te dallueshme nga markat kundershtuese.

Gjykata thekson se objekti i kundershtimit dhe kerkese-padise nuk mund te jete marka "Gjergj Kastrioti {...}" e Personit te trete. Ne rast se Paditesi ka ndonje pretendim mbi vlefshmerine dhe regjistrimin e markave "Gjergj Kastrioti {...}" te Personit te trete, atehere ai duhet te inicoje procedura te veganta per shfuqizimin e ketyre markave.

Referuar pergjigjeve me shkrim qe i Padituri ka depozituar ne vijim te pyetjeve te Paditesit (seanca gjyqesore e dates 20.11.2020), konfirmohet ne menyre te qarte se elementi {...} eshte element i pamjes se markes dhe marka eshte e mbrojtur ne teresine e saj ashtu sig eshte aplikuar.

Per me teper, vete aplikanti i markes ka deklaruar perjashtimin nga mbrojtja te elementit {...}, por ky deklarim nuk nenkupton se ky element do te fshihet nga pamja e markes. Deklarimi i perjashtimit do te thote vetem se pronari nuk mund te kete te drejta ekskluzive mbi kete term, por ai do te mbroje dhe regjistroje marken ne teresine e saj.

Gjithashtu, i Padituri konfirmon ne pergjigjen nr. 9 te tij se ekzaminuesi ka kryer nje raport hetimi per marken {...} dhe nuk ka rezultuar asnje marke e ngjashme apo identike me marken e aplikuar. Ne vijim, i Padituri ka paraqitur emertimin e markes ne regjistrin e tij (marka emertohet {...}) dhe riprodhimin ne permasa te medha e te qarta te markes. Pra, nisur nga pyetjet dhe pergjigjet e paleve, rezulton serish se markat nuk jane aspak te ngjashme ndermjet tyre.

Ne vijim per sa me siper, eshte konfirmuar menyra e realizimit te analizës krahasuese nga organi kompetent (vleresimi i ngjashmerise se pergjithshme ne nivel vizual, fonetik dhe konceptual) dhe fakti se konsumatore do te shohin dhe vleresojne marken ashtu sig ajo eshte regjistruar. Gjithashtu, i Padituri deklaroi se *"Bordi i Apelit ka konstatuar me te drejte dhe ne referim te ligjit se elementi "Kantina e Pijeve Gjergj Kastrioti {...}" i shkruar me shkrim te vogel rezulton gjithashtu i regjistruar si marke ne bazen e te dhenave DPPI" (shih pergjigja nr. 12) dhe "Paditesi dhe Personi i trete kane regjistruar secili markat e tij "Gjergj Kastrioti {...}" (shih pergjigja nr. 18).*

Per sa me siper gjykata gmon se vendimarrja e pales se paditur eshte marre duke u bazuar ne pretendimet e provat e paleve, si dhe ne nje gjykim analitik te detajuar te ngjashmerise se markave dhe mallrave te cilat ato mbulojne, duke u bazuar ne parimet dhe standardet e pergjithshme te krahasimit, tashme te konsoliduara nga praktika e fushes se pronesise industriale dhe ne mbeshjtetje te dispozitave te ligjit nr. 9947, date 07.07.2008 "Per Pronesine Industriale", i ndryshuar.

Perfundimisht gjykata gmon se kerkese padia per shfuqizimin vendimit nr.33/ Prot., date 24.05.2019, te Dhomes per Shqyrtimin e Kundershtimeve dhe vendimit nr.33/16 Prot., te dates 17.12.2019 te Bordit te Apelit te Drejtorise se Pergjithshme te Pronesine Industriale eshte e pabazuar ne ligj dhe ne prova dhe si e tille duhet rrezuar si e pabazuar ne ligj dhe ne prova.

Ne rastin konkret, shpenzimet gjyqesore te provuara te jene kryer prej pales kerkuese perbehen nga tarifa per sherbimin gjyqesor ne masen 3.000 Lek dhe shpenzime per realizimin e njoftimeve ne masen 200 Lek, sipas mandatit perkates.

Referuar pretendimit te personit te trete per ngarkimin e shpenzimeve gjyqesore te kryera nga ana e Bordit te Mbikqyrjes Publike per pjesemarrjen ne gjykim, Gjykata vlereson se, nuk ka vend per pranimin e ketij pretendimi per vet karakteristikat qe ka pjesemarrja e personit te trete ne procesin civil, ku ketij te fundit nuk mund ti ngarkohen detyrime dhe as te perfitoj te drejta prej gjykimit, rrjedhimisht as shpenzimet perkatese te realizuar gjate gjykimit prej personit te trete, nuk mund t'i ngarkohen kerkesit.

Duke pasur parasysh se, sipas nenit 106 te K.Pr.Civile, i cili gjen zbatim ne mungese te nje percaktimi ligjor te shprehur nga ligji organik nr. 49/2012, ne kushtet kur kerkesa u rrezua, Gjykata vlereson se shpenzimet gjyqesore te provuara te parapaguar te pales paditese duhet t'i ngarkohen asaj.

Per keto arsye

Baza Ligjore:

Gjykata bazuar ne nenet nenet 40-41 te Ligjit nr.49/2012 « Per organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimit e mosmarreshjeve administrative »

VENDOSI:

Vendosi:

1. Rrezimin e kerkese-padise si te pabazuar ne ligj dhe ne prova.
2. Shpenzimet procedurale gjyqesore i ngarkohen pales paditese.
3. Kunder ketij vendimi mund te behet ankim ne Gjykatën Administrative te Apelit brenda 15 diteve nga e nesermja e komunikimit te vendimit te arsyetuar.

U shpall ne Tirane me date 01 Dhjetor 2020.

SHPENZIMET GJYQESORE

Kerkesepadia 0

Taksa Gjyqesore 0

Noterizime 0

Njoftime Akt	0
ekspertimi	0
Avokat	0
Gjithsej	0

GJYQTAR:

{...}